



**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS  
NË PËRURIMIN E SALLËS SË MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE**  
*20 nëntor 2012*

Ministër Halimi,  
Zonja dhe zotërinj,

Është një çast i veçantë për mua dhe ekipin tim të jemi të pranishëm në këtë përurim, në prani të kaq shumë gjyqtarëve, prokurorëve, shoh edhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe miqve ndërkombëtarë që kanë kontribuar në këtë hap të ri shumë sfidues dhe shumë të rëndësishëm, që e ngjit shërbimin e provës në një nivel tjetër, në një nivel shumë modern e të shkëlqyer. Ne i shohim këto projekte si pjesë e reformës tërësore në drejtësi, e cila është qartësisht pjesë e mandatit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Javën e kaluar, në një veprimtari për Shërbimin e Provës, ku isha i pranishëm bashkë me ju, Ministër Halimi dhe me Ministrin e Brendshëm, përgëzova hapat e mëdhenj dhe novatorë në reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Hapja e kësaj sale për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike është një sinjal përkushtimi për t'i zbatuar fjalët dhe konceptet ligjore në praktikë.

Këto përpjekje duhen lavdëruar. Ato tregojnë se qeveria dhe autoritetet shqiptare mund të arrijnë rezultate kur ka vullnet të vërtetë për të punuar së bashku për të zgjidhur problemet dhe për të ecur përpara me reformat.

Ato janë, gjithashtu, një sinjal që tregon rëndësinë e partneritetit ndërinstitucional për të bërë hapa para me axhendën e reformave. Grupi i punës, i krijuar për këtë qëllim në janar, është një shembull i këtij bashkëpunimi.

Suksesi në luftën kundër krimit është detyrim për të gjitha vendet. Garantimi i sigurisë së qytetarëve është detyrë thelbësore për çdo shtet, çdo qeveri – dhe, sigurisht, nuk është punë e lehtë.

Megjithatë, që kjo detyrë të realizohet, është po aq e rëndësishme që të drejtat e njeriut të autorëve të veprave penale, të cilët bëhen pjesë e sistemit të drejtësisë penale, të respektohen plotësisht.

Prezantimi i sistemit të ri të shërbimit të provës ka kontribuar në uljen e mbipopullimit në burgje dhe mund të lehtësojë riintegrimin në shoqëri.

Mbikëqyrja me pajisje elektronike e të dënuarve, metodë e njohur në shumë vende evropiane si një zgjidhje alternative ndaj qëndrimit në burg, shkon në të njëjtën vazhdë – pra, që sistemet moderne dhe efektive të drejtësisë penale dhe të drejtat e njeriut nuk bien ndesh. Ato mund të funksionojnë paralelisht.

Ministër Halimi,  
Zonja dhe zotërinj,

Mbikëqyrja elektronike është një koncept modern. Shqipëria ka meritën e të qenit vendi i parë në rajon që ka përqafuar këtë sistem.

Pas përvojës së përbashkët dhe nxitëse të grupit të punës, kam bindjen se do të vazhdoni të bëni një punë të mirë!

Krenaria është diçka e madhe, prandaj mund të ndahet me të tjerët. Lejomëni t'ju bashkohem këtë herë, Ministër Halimi, mbi bazën e kontributit të ekipit tim. I uroj sistemit të drejtësisë, policisë dhe Ministrisë të Drejtësisë shumë sukses me sistemin e ri.

**Fund**